

NJOFTIM PËR SHTYP

Në në orën 9.00 të datës 19 Maj 2009, në ambientet e Hotel Tirana Internacional, zhvillohet Konferenca e parë e Infrastrukturës së Cilësisë në Shqipëri.

Konferenca organizohet nga tre Institucionet Shqiptare të Infrastrukturës së Cilësisë, respektivisht:

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; dhe
Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

Organizimi i kësaj konference këtë vit, do të pasohet nga konferenca të tjera në vitet në vazhdim, duke krijuar kështu traditën e një forumi apo tavoline të rumbullakët, ku grupet e operatorëve ekonomik, kërkuesve shkencor e rregullatorëve ligjor, të kenë mundësinë të shkëmbejnë arritjet dhe shqetësimet e tyre, si dhe të krijojnë lidhjet e domosdoshme për projekte të suksesshme për një zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri.

Në konferencë do të marrin pjesë individë dhe institucione të rëndësishme nga Shqipëria dhe Vendet e Rajonit.

Për vetë rëndësinë që ka zhvillimi dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës së cilësisë, e cila i shtrin efektet e saj në ekonomi, në sigurinë e jetës dhe shëndetit të publikut, në rritjen e konkurrencës për bizneset e vogla e të mesme, si dhe për mbrojtjen e konsumatorit, konferenca do të zhvillohet me praninë e zotit Genc Ruli, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i cili do të mbajë edhe fjalën e hapjes në këtë takim.

Është parashikuar që konferenca të ketë të gjitha atributet e një konference shkencore për të ndihmuar kështu edhe në zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat me interes për ekonominë vendase e më gjerë.

Disa nga temat e referimeve në këtë konferencë janë:

1. Menaxhimi i Cilësisë - Koncepte, Principe, Programe dhe Filosofitë mbi to;
2. Cilësia e jetës;
3. Sistemet e integruara të menaxhimit;
4. Standardet dhe cilësia në organizata;
5. Standardet dhe cilësia e siguria e produkteve, proceseve e shërbimeve;
6. Standardet dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;
7. Standardet dhe legjislacioni Evropian e ai Shqiptar;
8. Matjet, kontrolli dhe cilësia në prodhim;
6. Përmirësimi i proceseve dhe përmirësimi i performancës;
7. Sistemet e çertifikimit;
8. Pasiguria në matje, krahasimet ndërlaboratorike dhe vlefshmëria e metodës;
9. Organizmat e vlerësimit të konformitetit dhe akreditimi i tyre;
10. Etalonet kombëtare: krijimi, mirëmbajtja dhe krahasimet ndërlaboratorike;
11. Gjurmueshmëria, kalibrimi dhe pasiguria;
12. Materialet referuese: prodhimi, çertifikimi dhe përdorimi;

KONTAKTET:

1- Për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit - Vladimir Misha - Kryevlerësues në DPA
vmisha@albanianaccreditation.gov.al

2- Për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë - Nysjola Dhoga - Përgjegjëse e Sektorit të Integritetit; nysjola.dhoga@dpmk.gov.al

3- Për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit - Anita Peta - Përgjegjëse e Sektorit të Marketingut - peta.a@dps.gov.al . Tel: 04 222 62 55